



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 624 - 2/ 2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane, për Rishqyrtimin e Vendimit të PZAP-së, Anr.624/2021 të datës 18.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar, kërkesa e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane, Anr. 624-2/2021 e datës 21.10.2021, më të cilën ka kërkuar që të rishqyrtohet Vendimi i PZAP-it, Anr.624/2021 të datës 18.10.2021, me të cilin ju është shqiptuar dënimi më gjorbë në lartësi prej 300.00 euro, në emër të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Paneli për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin Anr.624/2021 të datës 18.10.2021, në pikën -I-, të dispozitivit ka vendosur që të **PRANOHET** e bazuar ankesa Anr.624/2021 të datës 17.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), ndërsa subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane i shqiptohet gjorbë, në lartësi prej 300.00 euro (treqind), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për zgjedhjet lokale të datës 17.10.2021. Në pikën II, ka vendosur **DETYROHET** Subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane – (PLE), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

Kundër këtij vendimi Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane, me datë 21.10.2021, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit, me të cilën ndër të tjera pretendon se

video e publikuar në profilin tim në facebook, fare nuk kishte bënte me ndikim potencial ndaj votuesve, por publikimi i asaj video kishte qëllim humanitar, me qëllim të mirë, për përfundimin e 37 shtëpive për familjet me nevojë të nisura në vitin 2019, dhe besoj se nuk kam vepruar fare në kundërshtim me nenin 8 të rregullores zgjedhore nr.13/2013. Gjithashtu ka theksuar se konstatimi i PZAP-së se unë si kryetar i PLE-së, jam kundërshtar politik i IRDK-së, konsideroj se është i pa bazuar për faktin se nuk kam qen fare në garë si kandidat, e po ashtu ju konfirmoj me përgjegjësi të plotë se në asnjë komunë nuk kemi qenë në garë me subjektin politik IRDK. Gjithashtu ju bëjmë me dije se ne si PLE, që nga 14 shkurti 2021, nga zgjedhjet Parlamentare ne nuk jemi pjesë e Parlamentit të Kosovës, nga ajo kohë nuk marrim fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Kërkesa për Rishqyrtim të vendimit është e **pabazuar**.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit në kërkesën për rishqyrtimin e vendimit Anr.624/2021 të datës 18.10.2021, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i lartcekur për faktin se video në të cilën është mbështetur PZAP, nuk dëgjohet mirë, duke pretenduar se për asnjë moment nuk ka bërë thirrje për të votuar subjektin politik PLE, e as thirrje për mos përkrahje të subjektit IRDK, këto pretendime Paneli i refuzon si të pa bazuara. Në rastin konkret kemi të bëjmë me publikimin e një video gjatë heshtjes zgjedhore, në të cilën video kritikohet kundërshtari politik, përkatësisht Zëvendës Kryetari i subjektit politik IRDK, e që një veprim i tillë konsiderohet shkelje e heshtjes zgjedhore dhe si e tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton se: “ *veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*”, prandaj një veprim i tillë është gjobitur nga ana e PZAP-së.

Pretendimi i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane, se në asnjë komunë nuk e ka pas kundërshtar subjektin politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – (IRDK), për Panelin ky pretendim është irelevant dhe si i tillë nuk ka ndikim në mënyrën e vendosjes, sepse subjekti në fjalë ka bërë thyerje të heshtjes zgjedhore dhe se thyerja e

heshtjes zgjedhore nuk lidhet fare me pretendimin se a janë kundërshtar në ndonjë komunë apo jo.

Pretendimet e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane, se e njëjta nuk merr fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës që nga Zgjedhjet e 14 shkurtit 2021, paneli vlerësoi se një pretendim i tillë është i pa ndikueshëm në vendim, kjo për faktin se subjekti në fjalë ka marrë pjesë edhe më herët në zgjedhje dhe ka qenë i njoftuar me shkeljet eventuale të ligjit për zgjedhje dhe pasojat që bartin këto shkelje. Gjithashtu paneli në rastin e lartësisë së gjobës i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e pretenduara nga subjekti politik PLE dhe konsideron se lartësia e gjobës është në përputhje të plotë me shkeljen të cilën e ka bërë subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane. Për më tepër Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par. 3 të LZP-së, dhe për secilin rast i merr parasysh rrethanat rastit konkret, për caktimin e shumës së gjobës për subjektet politik.

Me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118.4, me të cilin përcaktohet se: *“Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*. Në rastin konkret subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane, kërkesën për rishikim të vendimit nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri që do ta binde panelin që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që apelin- kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 par. 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.624-2/2021 më datën 22.10.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.